



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:205047

Datë: 28.03.2024

Numri i dokumentit: 05517050

Ac.nr.6325/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit Nora Bllaca- Dula dhe Ylber Shurdhiqui, anëtarë, në çështjen juridike kontestimore të paditësve I.S dhe N.S. të dy nga Peja, rruga “..., nr....., kundër të paditurit D.G. nga Peja, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson V.M. avokat nga Peja, për lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, duke vendosur sipas ankesës së paditësve, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1125/19 i datës 29.09.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësve I.S dhe N.S. të dy nga Peja, rruga “..., nr....., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.1125/19 i datës 29.09.2020, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1125/19 i datës 29.09.2020, në pikën I (një) të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësve I.S dhe N.S. të dy nga Peja, me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet i padituri D.G. nga Peja, ta liroj pjesën e ngastrës kadastrale nr. 693/5 dhe nr.693/7, ZK Pejë, bashkëpronësi e paditësve me gjatësi prej 5.5 m dhe gjerësi prej 8 cm, të njëjtën sipërfaqe t’ua dorëzoj paditësve në posedim të lirë si dhe t’ua paguaj shpenzimet gjyqësore, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Në pikën II (dy) të dispozitivit i ka detyruar paditësit I.S

dhe N.S. të dy nga Peja që të paditurit D.G. nga Peja t'i paguajnë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 964 € në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, nën kërcenim të përmbarrimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi paditësit në afat ligjor kanë paraqitur ankesë duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe kërkesëpadia e paditësve të aprovohet si e bazuar apo i njëjti të priset dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

I padituri nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ka ushtruar përgjigje në ankesë me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të paditësve, me propozim për Gjykatën e Apelit që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e paditësve dhe ta vërtetoj aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e paditësve është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit I.S dhe N.S. të dy nga Peja, në gjykatën e shkallës së parë kanë paraqitur padi kundër të paditurit D.G. nga Peja për lirimin dhe dorëzimin e paluajtshmërisë, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1125/19 i datës 29.09.2020, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar .

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë nxjerrjen dhe administrimin e provave përfshirë këqyrjen e gjykatës në vend me ndihmën e ekspertit të gjeodezisë si dhe nxjerrjen e provës me ekspertizë të gjeodezisë nga ekspertët Sh.K., dhe D.K. të datës 17.07.2020 nga të cilat ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar pasi që me provat e lartcekura e sidomos nga matjet e realizuara nga ekspertet gjyqësor në vend, është konstatuar se i padituri ka ndërtuar vetëm brenda kufijve kadastral të ngastrës nr.692/2 ZK. Pejë që është ngastër në pronësi të tij. Në fund ka shtuar se meqë nga provat e nxjerra dhe të administruara ka rezultuar se muri i ndërtuar nga i padituri shtrihet /ndodhet brenda kufijve kadastral zyrtar të parcelës nr. 692-2 dhe se në asnjërin anë gjeografike mur nuk shtrihet në kuadër të parcelës së palës paditëse nr.693-5, mbi këtë bazë kërkesë padinë e paditësve e ka refuzuar si të pa bazuar.

Për bazën juridike gjykata i është referuar dispozitës së nenit 37.1 dhe 2 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike dhe dispozitës së nenit 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore.

Vendimin lidhur me shpenzimet procedurale gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 449, 452.1 dhe 463.2 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu gjendja faktike del të jetë vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Pretendimi ankimor i paditësve se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm, për faktin se një pretendim i tillë nga paditësit është dhënë në mënyrë të gjeneralizuar dhe të paqartë duke mos precizuar dhe konkretizuar se cilat dispozita janë shkelur dhe ku konsiston shkelja e pretenduar.

Nuk janë pranuar pretendimet ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike sepse gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit, të gjitha faktet thelbësore kontestuese i ka provuar me mjete të përshtatshme dhe të besueshme provuese dhe rrjedhimisht edhe i ka arsyetuar të njëjtat në raport me normën e zbatuar. Nga provat e administruara të cilat janë propozuar nga palët ndërgjyqësore, e të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë përfshirë edhe marrjen e provës me këqyrjen e gjykatës dhe ekspertizën e ekspertëve të gjeodezisë si dhe provat tjera materiale, rezulton se hetimi i çështjes në këtë rast është bërë në masë të mjaftueshme sepse gjykata ka arritur të konstatojë gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë për rrethanat që janë me rëndësi në këtë rast dhe atë rrethanën se i padituri me ndërtimin e objektit të ri nuk ka uzurpuar paluajtshmërinë e paditësve ngase i padituri ka ndërtuar vetëm brenda kufijve kadastral të ngastrës nr.692/2 ZK. Pejë që është ngastër në pronësi të tij dhe se muri i ndërtuar nga i padituri ndodhet brenda kufijve kadastral të parcelës nr. 692-2 dhe se në asnjërinë anë gjeografike i njëjti mur nuk shtrihet në kuadër të parcelës së palës paditëse nr.693-5, andaj vlerësimi i provave nga gjykata e shkallës së parë dhe përfundimi i nxjerrë nga vlerësimi i tyre është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pabazueshmërinë e kërkesëpadsisë së paditësve është i drejtë dhe i argumentuar. Me dispozitën e nenit 93 të Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore Nr. 03/L-154 i cili ka qenë në fuqi në kohën e ushtrimit të padsisë në gjykatë është paraparë që: *“pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi”*, ndërsa me dispozitën e nenit 104 është paraparë se: *“posedimi është i ligjshëm po që se mbështetet në bazën e plotfuqishme juridike”*.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e

cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike kontestimore dhe me të drejtë e ka refuzuar kërkespadinë e paditësve në këtë procedurë, të cilin qëndrim e përkrah edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë.

I drejtë del të jetë vendimi mbi shpenzimet e procedurës i cili është në përputhje me dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së sipas së cilës dispozitë pala e cila humb procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore, andaj rrjedhimisht edhe pretendimi ankimor i paditësve për zbatim të gabuar të së drejtës materiale përkitazi me shpenzimet e procedurës është i pa bazuar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin ... të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.6325/20, me datë 27.03.2024.

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v.